

ROLI I REXHEP QOSJES NË NDRIÇIMIN E RILINDJES KOMBËTARE DHE KONTEKSTUALIZIMIN E LETËRSISË SHQIPTARE TË PERIU DHËS SË ROMANTIZMIT

Teuta ARIFI

Katedra për gjuhë dhe letërsi shqipe, Shkup

Abstract

The aim of this paper is to highlight a part of the multifaceted work of Professor Rexhep Qosja, specifically his contributions as a historian of Albanian literature. A notable contribution of his in this field is the three-volume work *The History of Albanian Literature – Romanticism*. During the period when this invaluable work was published, namely in the 1980s, Albanians living in the former Yugoslav Federation lacked systematic works on the history of literature as well as broader analytical perspectives on the works of Renaissance literature. *The History of Albanian Literature – Romanticism*, in addition to the breadth of its inclusion of authors, is also characterized by its innovative approach in placing Albanian Upheval Literature on a comparative plane with European literature and intellectual thought of the 19th century.

Keywords: National Upheval, Romanticism, history, Europe, Balkans;

Abstrakt

Qëllim i këtij punimi është vënia në pah e një pjese të veprimtarisë poliedrike të profesor Rexhep Qosjes, pra veprimtarisë së tij si historian i letërsisë shqiptare. Një kontribut i veçantë i tij në këtë lëmi janë tre vëllimet e veprës *Historia e Letërsisë Shqipe-Romantizmi*. Në periudhën e botimit të kësaj vepre me vlerë të jashtëzakonshme, pra gjatë viteve 80të të shekullit të kaluar, shqiptarëve që atëbotë jetonin në ish-Federatën Jugosllave u mungonin veprat e sistematizuara sa i përket historisë së letërsisë si dhe mungonin dhe vështirime nga një aspekt më i gjerë analitik të veprave të letërsisë rilindase. *Historia e Letërsisë Shqipe-Romantizmi* përveçse për nga gjerësia e përfshirjes së autorëve, karakterizohet edhe për nga inovacioni në qasje dhe në vendosjen në një rrafsh krahasues të letërsisë shqipe të Rilindjes me letërsinë dhe mendimin intelektual evropian të periudhës së shekullit 19të.

Fjalë kyçe: Rilindja Kombëtare, romantizmi, historia, Europa, Ballkani;

Shënime hyrëse

Periudha e Rilindjes Kombëtare shqiptare përbën kohën e ndërtimit, zgjimit, vetëdijësimit dhe ndërtimit të kombit në kuptimin e ngritjes së identitetit kolektiv kombëtar në periudhën e ndërtimit të këtij identiteti edhe tek kombet e tjerë të Europës Lindore dhe asaj Juglindore. Ky proces i rilindjes kolektive ka të bëjë me fillimisht dobësimin e më vonë rrënimin e Perandorisë Otomane, si dhe me aktivizimin politiko-diplomatik të Fuqive Ndërkombëtare në dinamikat e këtyre proceseve shtet-ndërtuese dhe ndërtimit të identitetit etnik. Ballkani merr fizionominë e sotme etno-politike pikërisht gjatë këtij procesi kompleks të ndërtimit të kombeve dhe shteteve, një proces i cili për shkak të mungesës së ekuilibrit mes fuqive politike ndërkombëtare dhe ndikimeve politike Perëndim-Lindje gjatë shekullit 19të, vazhdon të mbetet një Rajon turbulent pikërisht si rezultat i çështjeve etno-politike akoma të papërmbyllura plotësisht. Shikuar nga ky aspekt Rilindja jonë kombëtare përbën lëvizjen intelektuale e cila është e gjerë dhe gjithëpërfshirëse si për nga aspekti territorial, ashtu edhe për nga aspekti i përkatësive të ndryshme religjioze të autorëve, si dhe sa u përket botëkuptimeve ideore, filosofike dhe politike

të cilat i karakterizojnë këta autorë dhe veprimtarë të Rilindjes. Të gjitha këto dallime reale, autorët e Rilindjes i relativizojnë me një qëllim të vetëm, atë të bashkimit brenda një gjuhe të vetme-shqipe dhe një identiteti kombëtar, atij-shqiptar. Pra, duke pasur parasysh vlerën e padiskutueshme të Rilindjes Kombëtare dhe gjithnjë duke mos harruar faktin që gjatë kësaj periudhe merr një intensitet të veçantë letërsia shqiptare e karakterit laik ndryshe nga periudhat paraprake të letërsisë me karakter religjioz (Qosja, 1984:9), e një rëndësie të veçantë mbetet të shkruarit e historisë së kësaj periudhe të jashtëzakonshme dhe veçanërisht të shkruarit e historisë së letërsisë shqipe të Rilindjes Kombëtare. Po qe se nisemi nga definicioni se: *po të mos njohësh historinë atëherë nuk di asgjë dhe je një gjeth që nuk e di që është pjesë e një druri*, (Crichton,1999), atëherë është e qartë se një vepër e historisë së letërsisë ka këtë funksion kyç në ndërtimin e memorjes kolektive mbi një periudhë e cila për nga veprimtaria dhe pasuria ideore, kulturore dhe gjuhësore, determinon atë që ne përfaqësojmë sot si popull, gjuhë dhe kulturë. Prandaj edhe vepra trevëllimëshe e profesor Rexhep Qosjes *Historia e Letërsisë Shqipe – Romantizmi, I,II dhe III*, është vepër e cila determinon, mëson dhe memoron këtë periudhë të jashtëzakonshme të ndërtimit identitar shqiptar, duke lidhur degët dhe gjethet e shpërndara me një trung të vetëm, atë të identitetit shqiptar. Ashtu siç do të shprehet edhe vetë profesor Qosja, letërsia e romantizmit përfaqëson periudhën më homogjene të letërsisë shqipe në kuptimin e stilistikës, strukturimit të saj, gjuhës shqipe si e mëvetësuar dhe mbi të gjitha kjo letërsi shquhet për demokratizimin e shprehjes letrare si letërsi e cila është në shërbim të kombit në përgjithësi. (Qosja, 1984:11). Gjithësesi që njëra nga vlerat e veçanta të kësaj *Historie të letërsisë shqipe* është sistematizimi i veprimtarisë letrare së periudhës së shekullit 19të por të çliruar nga ngushtimet ideologjike kur kemi parasysh faktin që kjo vepër është botuar në vitin 1984 në Prishtinë. Sistematizimi dhe studimet për historinë shqiptare në përgjithësi dhe ato për letërsinë shqiptare në veçanti kanë pasur edhe elementin e ideologjizimit në qasjen jo vetëm ndaj fenomeneve të caktuara, por edhe në përcaktimin se cilët autorë do të jenë pjesë e historive dhe antalogjive të caktuara e cilët jo. Pa dashur të vemë në pikëpyetje rëndësinë e madhe që kanë studimet e shumta të realizuara në Shqipëri përgjatë periudhës 1945-1990, megjithatë nuk mund të lëmë pa nënvizuar që bashkë me të dhënat për figuart dhe periudhat historike-letrare ishte e gërshetuar edhe qasja socio-klasore dhe dhe folklorizmi politik si një barrë mbi studimin e historisë së letërsisë (Abazi&Doja, 2016). Dhe kjo anësi ideologjike dhe metodologjike ka përcaktuar modelet e vjetëruara të përcaktimeve kulturore (Doja, 2014:309). Studimet e letërsisë dhe përgjithësisht studimet shqiptare kanë fatin e vetë kombit shqiptar si komb i ndarë pa vullnetin e tij. Kështu që këto studime përgjatë një gjysmëshekulli zhvillohen jo vetëm të ndara por edhe nën ndikimet e pashmangshme ideologjike dhe dallohen për nga mungesa e komunikimit dhe këmbimit shkencor si rezultat i rrethanave të kësaj kohe. I vetëdijshëm edhe për këtë moment të realitetit kombëtar, profesor Qosja është kontribues në ngritjen e historisë sonë letrare mbi ndarjet e ndryshme të imponuara nga faktorë jashtaletrarë dhe jashtartistik. Dhe mes tjerash janë këto edhe arësyet e sulmit që i drejtohen personalisht Rexhep Qosjes nga shkrimtarë-eksponenë të regjimit jugosllav duke e kritikuar veçanërisht vendosjen në kontekst evropian të letërsisë shqipe të romantizmit në veprat e tij të historiko-letrare. Ky debat i hapur asokohe i cili shënoi fillimin e polemikës intelektuale mbi çështjet e papërfunduara ballkanike dhe që do të vijojë me ndryshime rrënjësore të hartës së Ballkanit, edhe një herë dëshmon jo vetëm rëndësinë letrare të veprës së profesor Qosjes, por mbi të gjitha edhe largpamësinë e tij intelektuale.

Romantizëm apo diçka më shumë

Me një interes të veçantë është fakti që këtë periudhë letrare shqiptare të shekullit 19të profesor Qosja e identifikon si *romantizëm*, duke dashur në këtë mënyrë të bëjë dallimin mes drejtimit letrar që karakterizon letërsinë europiane të shekullit 19të dhe lëvizjes kombëtare shqiptare të quajtur nga vetë autorët e kohës si *Rilindje Kombëtare*. Romantizmi si drejtim letrar mbetet identiteti parësor i letërsisë europiane të shekullit 19të, gjithnjë duke pasur parasysh faktin që romantizmi në letërsinë europiane erdhi si një reaksion letrar ndaj klasicizmit, por në kuptimin ideor romantizmi europian ishte reaksion ndaj racionalizmit në kuptimin filosofik dhe poashtu ishte reaksion ndaj koncepteve të Revolucionit Demokratiko-Borgjez francez si premtime të parealizuara në kuptimin politik (Kohan, 1971:321). Ky dëshprim intelektual ndaj racionalizmit i cili konceptualisht ndryshoi drejtimin zhvillimor jo vetëm të mendimit filosofik europian, por njëkohësisht edhe dinamizoi zhvillimin shkencor-natyror të Europës, u identifikua si *dhimbje e shekullit* e cila përbën bazën inspiruese të letërsisë romantike. Megjithatë, edhe brenda vetë letërsisë europiane shprehen dallimet në format dhe shkaqet të cilat sollën deri tek romanizmi apo romantizmet brenda shumësisë së gjuhëve dhe kulturave europiane. Si fillim, zhvillimet letrare por edhe ato artistike në përgjithësi nuk mund të kuptohen e aqë më pak të analizohen të veçuara nga trendet historiko-politike gjithnjë duke pasur parasysh faktin që letërsia dhe mendimi intelektual në të shumtën e rasteve paraqitet si pararendës i këtyre zhvillimeve. Në këtë kuptim, gjatë shekullit 19të në pjesë të ndryshme të Europës kemi edhe rrethana të ndryshme historiko-shoqërore, varësisht nga dinamikat gjeo-politike të cilat shënojnë këtë periudhë. Romantizmi europian ka frymën e përbashkët të idesë romantike e cila vendos emocionin si vlerë superiore ndaj arësyes/*ratio*-s dekartiane, e cila dhembjen shpirtërore e ka inspirim dhe epiqendër të veprës letrare dhe poezinë lirike si formën më të qëlluar dhe të preferuar për të shprehur këtë lumë emocional në letërsi. Megjithatë, edhe përkundër kësaj vlere përbashkuese të romantizmit europian, janë gjuhët e ndryshme ato në të cilat krijohen veprat letrare, gjuhë të cilat këtij drejtimi letrar i japin identitet kombëtar varësisht nga rrethanat shoqërore në të cilat gjenden kombet në Europë. Në këtë mënyrë kjo formë e shprehjes letrare, kjo letërsi e ndjenjës dhe e kthimit inspirativ ndaj vetvetes dhe dramës personale, kjo letërsi e cila vendos individin në epiqendër dhe formën e personalizuar të shprehjes dhe të kuptuarit e botës përreth, përputhet me procese tërësisht kolektive, lëvizje definitivisht antiindividualiste, lëvizje të organizuara shoqërore dhe politike të ndërtimit të kombeve dhe shteteve europiane ashtu siç i njohim sot.

Letërsia e romantizmit europian përputhet me procesin më të madh të rikonfigurimit etno-politik të Europës në kuptimin shumë më të gjerë të fjalës, pra, nëse nga shekulli 15të e gjer në shekullin e 19të idetë intelektuale kishin Europën Perëndimore si truall të vetëm të lindjes dhe zhvillimit të tyre, me fillimin e shekullit 19të idetë progresive shoqërore gjejnë rrugën e tyre edhe në pjesët e tjera të kontinentit europian duke e zgjeruar kuptimësinë e identitetit të përbashkët europian. Nëse letërsia e romantizmit francez dhe atij anglez karakterizohet me notat e thella individualiste, kjo mund ti përshkruhet faktit që Franca dhe Anglia kanë tejkaluar qëmoti proceset e shtetformësisë dhe dinamikat shoqëro-politike janë kryesisht dinamika të brendshme sa i përket rregullimit shtetëror dhe revolucioneve shoqërore. Edhe pse në rastin e letërsisë angleze studuesit e periudhës së romantizmit veçojnë katër letërsitë ato angleze, skoceze, uellsiane dhe irlandeze (Duff, 2021:229) megjithatë këto dinamika janë të ndryshme nga proceset e ndërtimit të identitetit kombëtar dhe shtetformimit në Europën Juglindore. Dhe letërsia bashkë me mendimin intelektual-filosofik kanë ndjekur këto trende shoqërore, kanë udhëhequr këto tendenca intelektualisht apo kanë reaguar ndaj këtyre zhvillimeve. Por, këto tendenca paraqiten tërësisht të ndryshme kur bëhet fjalë për pjesën e mbetur të kontinentit europian i cili kalon fazën e rikonfigurimit etno-politik dhe shtetëror, dhe procesi më madhor i cili shënon këtë rikonfigurim është formimi i shtetit të bashkuar gjerman. Në kuptimin politik

dhe shtetëror formimi i shtetit gjerman përfunimisht rrënon konceptin Risheljesë për një Gjermani të dobët karshi një France të fuqishme (Kissinger, 1999:105), dhe sjell poashtu dinamika të reja në proceset e shtetndërtimit në Europën Juglindore dhe atë Lindore. Këto dinamika gjermane kanë ndikimin e padiskutueshëm në idetë dhe formën e romantizmit gjerman i cili dallohet sipas disa karakteristikave specifike: të kërkuarit e origjinës mitologjiko-antike gjermanofone (Kënga e Nibelungeve, 2016), mbledhjen dhe ringjalljen e letërsisë popullore gjermane si dhe ndërtimin e vetëdijes së fuqishme për përdorimin dhe avansimin e gjuhës gjermane si gjuhë e intelektualizmit dhe filosofisë (Oergel, 1998:123). Duke pasur gjithnjë parasysh faktin që origjina e përbashkët e shprehur në një gjuhë dhe një të kaluar të përbashkët kolektive (Balibar, 1991:88), përbën momentin kyç në procesin e ndërtimit të vetëdijes kolektive kombëtare dhe rrjedhimisht shtetformimit, atëherë bëhet i padiskutueshëm dallimi në frymën dhe atmosferën që dallon romantizmin gjerman nga ai francez dhe anglez. Një frymë e ngjashme ndonëse më pak e shprehur e karakterizon edhe romantizmin italian i cili ndjek paralelisht procesin e formimit të shtetit italian pas kryengritjeve të organizuara dhe të udhëhequra nga Garibaldi me qëllim të çlirimit të Italisë nga nga Burbonët dhe Austro-Hungaria (Xoxi, 1979:180). Dhe kjo dinamikë shoqërore sa vjen bëhet më intesive dhe më komplekse tek popujt e Ballkanit. Ky kompleksitet është sa politik, shoqëror e filosofik, poaq identitar në kuptimin parësor të fjalës. Është kjo koha kur tek kombet e Ballkanit intensifikohet procesi i ndërtimit të vetëdijes kombëtare, proces ky i cili është paralel me lëvizjet e organizuara për çlirim nga sundimi shekullor i Perandorisë Otomane në pjesën juglindore të Europës. Ky proces tejet intensiv dhe i rëndësishëm është i veçantë mu për faktin që popujt e Ballkanit diferencojnë identitetet e tyre etno-kombëtare, pra si identitetet me të cilin ata identifikojnë vehten e tyre dhe identitetin me të cilin ata identifikohen nga të tjerët. Ky fenomen identitar ka të bëjë me kombet ballkanikë në përgjithësi dhe kombin shqiptar në veçanti. Në këtë proces të ndërtimit identitar ideologët e Rilindjes Kombëtare angazhohen për të dëshmuar si të veçantë dhe të ndryshëm identitetin shqiptar nga otomanizmi duke u bazuar në gjuhën e veçantë shqipe, origjinën antiko-pelazge dhe të kaluarën e cila dallohet me rezistencën ndaj pushtimit otoman nën udhëheqjen e Skënderbeut. Gjatë këtij procesi gjithësesi që me rëndësi të posaçme është edhe ndërtimi i identitetit karshi tjetrit që paraqitet si një sfidë e veçantë e Rilindjes, dhe kjo ka të bëjë me Orientin dhe orientalizmin si identitet me të cilin identifikohet Ballkani dhe kombet ballkanikë. Dhe në këtë drejtim me rëndësi të veçantë është të analizuarit dhe kuptuarit se çka paraqet Orienti për Europën dhe mendimin europian gjatë shekullit 19të. A është Orienti një zbulim europian, si një vend i romansës, natyrës së papërsëritshme, qenieve ekzotike dhe eksperiencave të jashtëzakonshme? (Said, 1979:2). Janë pra, pikërisht këto karakteristika ato të cilat romantizmi europian ia atribuon Orientit duke e shndërruar në një ideal të shkrimtarit romantik i cili Lindjen/Orientin e ka inspirim, dëshirë dhe destinacion të udhëtimeve të kësaj gjenerate të autorëve europianë. Në gjeografinë mendore të shkrimtarit romantik europian Orienti fillon me kufinj të perandorisë Otomane, duke e vendosur kështu Ballkanin si pjesë të këtij koncepti mendor dhe kulturor. Pra, romantizmi duke qenë një drejtim letrar i cili ndërton letërsinë dhe heroin romantik duke u bazuar mbi imagjinaren, atëherë na bëhet e qartë që Ballkani oriental është koncept imagjinar i romantizmit europian. Në fakt, është beteja intelektuale me këtë koncept ajo e cila mes tjerash e karakterizon procesin e ndërtimit etno-identitar të kombeve të Ballkanit, të cilët gjatë procesit të ndërtimit të tyre identitar angazhohen për tu shkëputur nga orientalizmi dhe të ndërtojnë një identitet kombëtar oksidental. Në procesin politiko-shoqëror të udhëhequr nga intelektualët dhe veprimtarët e Rilindjes ky koncept oksidental shpjegohet me orientimin politik të të kërkuarit të mbështetjes politike nga qendrat europiane të vendosjes ashtu që këto të fundit të përkrahnin themelimin e një shteti shqiptar në Ballkan (Degovitz, 2022). Ndërkaq në kuptimin e letërsisë e cila është shoqëruese e pandarë e lëvizjes rilindase, është orientimi europian ai që karakterizon këtë periudhë letrare, apo fenomen të cilin profesor Qosja e emërton si *europëizim* të letërsisë shqipe të kësaj kohe. Sipas tij, është kjo periudhë e

cila përshpejton procesin inkuadrimin të letërsisë shqipe në rrjedhat e letërsisë europiane (Qosja, 1984:98). Dalja e letërsisë shqipe nga tematikat religjioze paraprake, asaj krishtere dhe muslimane, krijon një horizont të gjerë tematik dhe të llojeve letrare, dhe mbi të gjitha kërkon dhe gjen temat europiane si një identitet të vetin dhe përkatësi të padiskutueshme kulturore. *Europeizimi*, ky koncept i përdorur nga ana e profesor Qosjes ka kuptimin e vendosjes së letërsisë dhe identitetit shqiptar brenda kornizave identitare europiane si pjesë e pandarë e kësaj kulture dhe botëkuptimi. Gjithësesi që kur flasim për konceptin e europeizimit nuk duhet lënë anash debatin e thellë rreth kuptimit të termit europeizim në raportin ndërkulturor mes Perëndimit dhe Lindjes. Janë këto kultura të cilat takohen me njëra tjetrën pikërisht në Ballkan dhe ashtu siç ndodh me pjekjet ndërkulturore, shpesh këto takime janë të ngarkuara nga paragjykimet që sjellin mosnjohja e njëra-tjetrës, apo kontekst rrethanor brenda të cilave këto kultura vijnë në komunikim mes tyre. Duke qënë një Perëndim për Lindjen dhe një Lindje për Perëndimin, Ballkani mbetet një identitet kompleks sa i përket formimit kulturor dhe ky kompleksitet shprehet akoma më fuqishëm gjatë shekullit 19të kur edhe ndodh procesi i ridefinimit identitar dhe shtetëror të Ballkanit. Letërsia e kësaj periudhe dhe në këtë drejtim veçanërisht letërsia shqipe është letërsi e angazhuar në këtë proces të rëndësishëm identitar, duke zgjedhur në mënyrë plotësisht të vetëdijshme të vihet në shërbim të procesit të ndërtimit të kombit dhe rrjedhimisht edhe shtetit. Kështu që kjo letërsi i vë vehtes si detyrë ngritjen e vetëdijes kombëtare së bashku me ngritjen e vetëdijes së përkatësisë europiane si pjesë e pandarë e identitetit kombëtar. Europeizimi siç e emëron profesor Qosja dhe siç e kupton Rilindja Kombëtare nuk e ka kuptimin kolonial siç trajtohet nga disa studiues qasja ndaj Ballkanit dhe asaj që do të quhej Periferi e Europës (Kiossev, 1995). Sepse për rilindasit tanë më pak ka rëndësi se cila është qasja e dijes dhe letërsisë europiane ndaj letërsisë shqipe, përkundrazi, e një rëndësie të veçantë është qasja e mendimit intelektual shqiptar dhe rrjedhimisht letërsisë shqipe ndaj Europës si koncept, si mendim dhe si përkatësi kulturore. Kthimi në traditën europiane për Rilindjen Shqiptare është e barasvlershme më qenësinë shqiptare, duke pasur parasysh faktin që kjo qenësi është pjesë e pandashme e të kaluarës kulturore europiane dhe meriton të jetë pjesë e të tanishmes dhe të ardhmes së Europës. Pikërisht për këtë arsye, letërsia e Rilindjes padiskutim që është romantizëm, por njëkohësisht shkon përtej romantizmit duke përfshirë brenda vetes iluminizmin, klasicizmin, didaktikën dhe linguistikën. Duke qënë të vetëdijshëm për rolin e tyre, intelektualët e Rilindjes funksionalizojnë këto drejtime letraro-filosofike për të ngritur idetë kombëtare dhe shtetërore, dhe këtë konstaton dhe profesor Qosja duke nënvizuar faktin që Rilindja Kombëtare është lëvizje të cilën e fillojnë dhe drejtojnë intelektualët ashtu siç intelektualët dhe letrarët ishin nismëtarët e Revolucionit Demokratik Borgjez Francez. (Qosja, 1984:42).

Kontekstualizimi kohor dhe hapësinor i romantizmit shqiptar

Vepra *Historia e Letërsisë Shqipe – Romantizmi*, përbëhet nga tre vëllime, nga të cilët në vëllimin e dytë dhe të tretë përfshihen pesëmbëdhjetë autorë të Rilindjes-romantizmit, ndërkaq, vëllimi i parë përbën një studim sistematik mbi veçoritë e kësaj periudhe letrare. Dhe është pikërisht ky vëllim i parë i kësaj *Historie* ai tek i cili kontekstualizohet kjo periudhë letrare nga më shumë aspekte. Aspekti i parë i këtij kontekstualizimi është vendosja e pikave hapësinore të zhvillimit të romantizmit dhe bashkë me këtë edhe shtrirja kohore e kësaj veprimtarie. Shtrirja e gjatë kohore e kësaj periudhe letrare ndërlihet me intensitetin e ngjarjeve historiko-politike të shekullit 19të të cilat përcaktojnë jo vetëm kohëzgjatjen e romantizmit, por njëkohësisht përcaktojnë edhe zhvillimet e të ardhmes politike të Ballkanit në përgjithësi. Pra, nëse e gjatë është koha historike brenda kufinjëve të së cilës lind dhe zhvillohet letërsia e kësaj periudhe, akoma më e madhe është gjerësia gjeografike e këtij drejtimi letrar. Njëra ndër çështjet e cila preokupon edhe historianët dhe studiuesit e romantizmit europian është pikërisht

periodizimi dhe vendosja e kufinjëve kohorë brenda të cilave lind dhe zhvillohet ky drejtim letrar (Halmi, 2021:234), gjithnjë duke pasur parasysh faktin që zhvillimet intensive shoqërore europiane parakushtëzuan që kjo periudhë letrare të zgjaste më shumë se drejtimet e tjera. Një konstatim të tillë sjell edhe profesor Qosja kur bëhet fjalë për kohëzgjatjen e romantizmit shqiptar, duke vlerësuar se ky drejtim letrar në letërsinë shqipe mbulon në tërësi më shumë se gjysmën e shekullit 19të dhe vazhdon më tej edhe në fillimet e shekullit 20 (Qosja, 1984:43). Kjo shtrirje më e gjerë kohore u dedikohet zhvillimeve intensive shoqërore dhe politike të cilat me intensitetin e tyre i japin romantizmit shqiptar tematikën dhe angazhimin kombëtar deri në shpalljen e pavarësisë në vitin 1912. (Qosja, 1979:331). Sigurisht që ashtu siç edhe thekson profesor Qosja, botimi i veprës *Katërbëdhjetë vjeç dhëndërr* nga Çajupi, shënon edhe fillimin e periudhës së realizmit në letërsinë shqipe, por megjithatë në kuptimin politik dhe shoqëror shekulli i 19të vazhdon edhe përtej kufinjëve kalendarikë si rezultat i çështjeve të pazgjidhura etno-politike dhe si rezultat i ngritjes me një dinamikë amplitudiale të ideve totalitariste të cilat në thelbin e tyre kishin mosdurimin etnik, gjuhësor apo racor. (Meadwell, 2001)

Nëse me vlerë të veçantë është vendosja e kufinjëve kohorë të romantizmit shqiptar, gjithësesi se me po aqë vlerë është edhe përcaktimi i gjerësisë gjeografike/hapsinore të këtij drejtimi letrar. Kjo gjerësi gjeografike e romantizmit shqiptar përbën interesimin analitik të profesor Qosjes, i cili duke dhënë informacione dhe shënime për të gjitha kolonitë në të cilat është zhvilluar romantizmi shqiptar (ajo e arbëreshëve në Itali, Stambolli, Bukureshti, Kairoja dhe Sofja), arrin që jo vetëm të përshkruajë këtë hapësirë të gjerë të botës shqiptare, por akoma më shumë, të na për afrojë filosofinë e cila bën që të gjitha këto qendra ti shërbejnë një qëllimi të vetëm, atij të ndërtimit të një lëvizjeje unike për të pasur një atdhe, gjuhë, kulturë dhe gjithësesi një shtet shqiptar me orientim europian. Sigurisht që janë rrethanat historike ato të cilat kanë paracaktuar këtë realitet gjeografik të botës shqiptare, duke u nisur nga shpërngulja e madhe e popullatës arbërore drejt Italisë gjatë mesjetës, për të vazhduar me shpërnguljet e karakterit ekonomik (gurbet) në drejtim të Rumanisë, Egjiptit dhe Bullgarisë dhe përfundimisht smadhimin të rëndësisë së Stambollit si një qendër e rëndësishme shqiptare si rezultat i shumë shqiptarëve që punonin në administratën e Perandorisë apo gjendeshin me shërbime të ndryshme në institucionet otomane si shtet administrativ brenda të cilit shqiptarët jetonin tanimë pesë shekuj.

Eurocentrizmi i romantizmit shqiptar

Njëra nga vlerat e veçanta të kësaj vepre historike të profesor Rexhep Qosjes është vendosja në rrafshin krahasues të letërsisë shqiptare me atë europiane, duke pasur parasysh përsëri kohën në të cilën krijohet kjo vepër, pra vitet 80të të shekullit të kaluar. Fillimisht është me rëndësi gjithësesi vënia në pah e orientimit europian të letërsisë shqipe të kësaj periudhe dhe ky orientim është pandashmërisht i lidhur me procesin e ndërtimit të identitetit shqiptar të cilin Rilindja jonë e sheh të gërshetuar me Europën dhe fatin e saj. Këtë krahasim profesor Qosja e vendos në kontekstin historik dhe kulturor duke theksuar pikërisht faktin që romantizmi i popujve ballkanikë bëhet letërsi e angazhuar në frymën e lëvizjeve çlirimtare të këtyre popujve. Ndërkohë që letërsia e romantizmit europian ka lirinë e krijimit letrar pikërisht si rezultat i këtyre çështjeve të përmbyllura shtetërore, romantizmi shqiptar do të jetë një letërsi e idealeve kolektive kombëtare (Qosja, 1984:349). Në një mënyrë të përpiktë në këtë vepër vendosen në rrafshin krahasues pikat e përbashkëta, dallimet mes këtyre drejtimeve letrare duke u shpjeguar edhe shkaqet objektive dhe subjektive të këtyre ngjashmërive dhe dallimeve të ndërsjella. Duke përdorur metodën e zbatuar krahasimtare dhe duke bërë dallimin mes dy koncepteve të pranishme kaherë në kritikën dhe historinë e letërsisë shqipe, pra të veçimit të plotë të letërsisë shqipe nga ajo europiane si koncept i parë, apo të përdorimit të përvojës moderne krahasimtare të letërsive si një koncept i dytë në qasjen e studimit të romantizmit në përgjithësi dhe

romantizmit shqiptar në veçanti, Rexhep Qosja përcaktohet për këtë koncept karahasues si qasje moderne dhe qasje e saktë për të përcaktuar vendin e kësaj letërsie në kornizat e letërsisë europiane. Ky vend në kornizat e letërsisë europiane vjen si rezultat i një historie të përbashkët të këtij kontinenti në kuptimin kulturor të kësaj fjale, por edhe si rezultat i ndërkomunikimit kulturor, letrar dhe artistik mes popujve të Europës. Sipas kësaj analize, komunikimet e natyrave tjera mes popujve edhe do të mund të ishin vështirësuar dhe ndërprerë mes kombeve të ndryshëm, por ama asnjëherë nuk janë ndërprerë komunikimet intelektuale, letrare dhe artistike.

Janë disa aspekte themelore mbi të cilat profesor Qosja vendos analizën e tij historiko-karahasimtare sa i përket romantizmit shqiptar dhe atij europian. Njëri nga këta aspekte është të definuarit e funksionit mbizotërues të romantizmit shqiptar karshi atij europian. Në këtë drejtim ai thekson distancimin nga realiteti objektiv i kohës së letërsisë romantike europiane e cila dallohet me dhënien përparësi imagjinare si një ishull i largët nga ky realitet kohor. Ndërkaq, duke vënë në rrafshin krahasues letërsinë shqipe, theksohet elementi i të qenit një letërsi e angazhuar dhe si e tillë pavarësisht romantizmit të saj e kishte të pamundur distancimin nga realiteti objektiv. Në këtë mënyrë ideali i përbashkët i rilindasve për të arritur deri tek pavarësia kombëtare bëhet dhe mbetet funksioni kryesor mbizotërues i romantizmit shqiptar, por veçues në kuptimin krahasimtar me romantizmin europian. Kur flet për marrëdhënien mes individit dhe shoqërisë sipas letërsisë romantike europiane, Rexhep Qosja citon historiannin e letërsisë P.S, Kohan i cili subjektivizmin e skajshëm e definon si karakteristikë kryesore të romantizmit europian duke ngritur kultin e individit dhe ndjenjave të tij (Kohan, 1967), dhe këtij koncepti individualist i vë përballë idenë e romantizmit shqiptar i cili vendos *unin kolektiv* para *unit individual*, gjithnjë duke theksuar prioritetin që letërsia shqiptare ia jep kolektives, kombëtares dhe ndërtimit të vetëdijes kolektive kombëtare. Në të njëjtin rrafsh mbetet edhe qasja që ka Rexhep Qosja ndaj dy koncepteve universale të romantizmit europian: nostalgjisë dhe historisë. Padyshim që nostalgjia si kuptim, ndjenjë dhe filosofi përbën kodin identifikues të romantizmit si drejtim letrar, dhe kjo shpjegohet sa me arësytet historiko-shoqërore të periudhës së lindjes dhe zhvillimit të romantizmit (Kohan, 1967), po aqë edhe me arësytet letrare duke përcaktuar këtë drejtim si shprehje letrare e individualitetit emotiv njerëzor karshi standardit të ashpër klasicist apo mendimit filosofik racionalist (Halmi, 2021). Duke mos e vënë në diskutim faktin që shekulli i romantizmit është shekulli i dhembjes, Qosja bën dallimin në natyrën e dhembjes romantike duke vlerësuar se dhembja është gjithësesi individuale, por shkaqet të cilat intensifikojnë atë janë të ndryshme. Në këtë drejtim dhimbjen e romantikëve shqiptarë ai e vlerëson si etike dhe shumë më të arësyeshme duke nënvizuar që nostalgjia e romantizmit shqiptar është nostalgji për atdheun e munguar dhe kjo nostalgji përbën thelbin inspirativ të lirikës romantike. Duhet vlerësuar se në këtë kontekst Qosja nuk ndalet më shumë për të kontekstualizuar nostalgjinë e romantizmit europian dhe për tu thelluar më tej në shkaqet e kësaj qasjeje kritike të këtyre romantikëve ndaj atdheut të tyre. Prandaj për të qenë më korrektë në këtë krahasim mes këtyre letërsive të një periudhe të njëjtë kohore, domosdo që është e nevojshme të vendosim në këtë rrafsh më shumë informacione dhe argumente sa i përket fenomenit të nostalgjisë sipas romantizmit europian. Nëse përjashtojmë këtu romantizmin gjerman i cili është i njëkohshëm me procesin e bashkimit të një pjese të madhe të territoreve gjermanofone dhe krijimin e shtetit gjerman, romantizmi anglez dhe ai francez janë shprehje e rrethanave historike dhe shoqërore brenda shteteve të cilat shumë më parë kanë përfunduar sfidat identitare dhe territoriale të shtetformimit dhe që tani kalojnë procese intensive të rirregullimit të brendshëm shtetëror dhe sfidat e para të demokracisë dhe të drejtave të njeriut. Dhe ky fenomen i tëhuajësimit të shkrimtarit karshi atdheut të tij ka të bëjë me pakënaqësinë njerëzore dhe intelektuale lidhur me proceset shoqërore si dhe kërkesat dhe betejat për ndryshime demokratike (Laugier, 2015:1040). Prandaj edhe dallimi mes këtyre shkrimtarëve lidhur me qasjen ndaj atdheut ka të bëjë me faktin që përderisa romantikët shqiptarë ndërtonin

idealin e një atdheu të lirë, të pavarur dhe të bërë, romantikët anglezë dhe ata francezë krijojnë distancën e tyre jo nga atdheu si koncept dhe si ekzistencë, por si një pushtet i cili nuk mundëson shprehjen e lirë demokratike dhe intelektuale. Shikuar nga perspektiva e sotme, është jashtëzakonisht e rëndësishme të ndërtuarit e një distance kohore në këtë lloj krahasimi, duke i ikur pragjyqimit të romantizmit europian si lëvizje e dëshpërimit pa arësye dhe glorifikimit të romantizmit ballkanik si lëvizje kombëtare.

Me po të njejtën frymë, Rexhep Qosja i qaset në mënyrë krahasimtare temës së historicizmit e cila së bashku me nostalgjinë përbën linjën identifikuese të romantizmit në përgjithësi. Ai vlerëson që është fakt i padiskutueshëm që romantizmi europian dhe ai shqiptar tematikën historike e kanë si një vijë përbashkuese në kuptimin tematik, por njëkohësisht veçuese po që se analizohen arësyet tejet të ndryshme në përdorimin e historisë tek romantizmi europian dhe ai shqiptar. Sipas këtij krahasimi dhe duke u mbështetur në mendimin e historianit të letërsisë Hauzer, romantikët europianë i drejtohen historisë si një vendstrehim nga realiteti objektiv me të cilin jo vetëm që këta shkrimtarë nuk pajtohen, por sikur edhe nuk kanë energjinë e nevojshme për të ndryshuar të njëjtin. Dhe në këtë mënyrë e kaluara historike dhe mistikja teologjike vjen si një inspirim intensiv i romantizmit europian. Ndërkohë, profesor Qosja vë në dukje që shkaqet e tematizimit të historisë janë tërësisht të ndryshme në veprën letrare të romantizmit shqiptar. Duke qenë një letërsi tërësisht e angazhuar, romantizmi shqiptar krijon një gjërësi tematike historike e cila shtrihet që nga periudha antike, përmes mesjetës shqiptaro-ballkanase e deri tek personazhet shqiptarë të aktualitetit të atëhershëm të cilët shquhen për pjesëmarrje në luftërat çlirimtare të kombeve tjerë të Ballkanit. Historia në veprat e romantikëve shqiptarë nuk ka vetëm rolin inspirativ, por njëkohësisht rolin edukativ, atë të mësueses jetësore siç edhe janë edukuar rilindasit shqiptarë në gjimnazet klasike në të cilat kanë marrë dhe edukimin e tyre filosofik dhe letrar. Duke pasur gjithnjë parasysh faktin që letërsia e Rilindjes është në funksion të ndërtimit të identitetit kombëtar, atëherë është e padiskutueshme që ky identitet nuk ndërtohet dot pa historinë dhe historicizmin (Balibar, 1991:86). Fillesat historike të këtij identiteti kolektiv shtrihen që nga antika pellazgjike duke pasur parasysh faktin që origjina pellazgjike e shqiptarëve nënvizohet si e drejta natyrore e shqiptarëve për të qenë më vehte si komb e si shtet dhe duke nënvizuar poashtu që në mënyrë të natyrshme shqiptarët për nga origjina ishin banorët më të vjetër të Ballkanit (Vasa, 1989). Në këtë vijë historiciste të ndërtimit identitar, romantizmi shqiptar sjell në veprat e veta letrare dy figura të lidhura me të njëjtin emër si një kumt paralajmërues historik: figurën e Lekës së Madh të Maqedhonisë dhe atë të Gjergj Kastriotit-Skënderbeut. Qëllim kryesor i këtyre autorëve është që duke ngjallur kujtesën historike të mbetur në memorjen kolektive dhe të shprehur përmes poezisë popullore, të rikrijojnë figura heroike në formë të heronjëve romantikë të cilët inspirojnë për të dashur, mësuar, punuar dhe luftuar për atdheun i cili nga një ide imagjinare do të duhet të kalojë në një realitet objektiv (Smith, 1991:353). Në këtë linjë të krahasimit të letërsive romantike shqiptare dhe europiane, Rexhep Qosja vë edhe qasjen ndaj religjionit/teologjisë, duke theksuar antiklerikalizmin e romantizmit shqiptar karshi teologjizmit të romantizmit europian. Gjithësesi që antiklerikalizmi i romantizmit shqiptar i dedikohet angazhimit të këtyre veprimtarëve kombëtarë e letrarë për të ndërtuar një identitet kolektiv kombëtar në të cilin etnosi do të jetë kryefjala identitare e kombit, duke pasur parasysh faktin që duke qenë një komb me tre përkatësi religjioze, ishte e një rëndësie të veçantë të vihehin në plan të dytë elementet ndarëse (në këtë rast përkatësitë fetare), përpara elementit përbashkues që ishte kombi dhe gjuha. Megjithatë, le hapësirë për tu diskutuar qasja ndaj romantizmit europian në kuptimin e tematikave teologjike. Sipas profesor Qosjes shkrimtarët e romantizmit europian mes tjerash kërkojnë strehimin e tyre në religjion si pasojë de-individualizimit të njeriut në sistemin eksploatues kapitalist (Qosja, 1984:354), duke gjetur tek religjioni mbështetjen e kërkuar njerëzore dhe shpirtërore. Sidoqoftë, gjithnjë duke pasur parasysh faktin që rrethanat e ndryshme shoqërore edhe parakushtëzojnë dallimet, shkrimtarët europianë

lëvizin më lirshëm brenda temave të caktuara si rezultat i faktit që këto tema nuk rrezikojnë qenien e tyre etnike dhe në pjesën më të madhe të Europës tani më ka përfunduar procesi i shtetformësisë kombëtare. Prandaj dhe tematika religjioze tek një pjesë e romantikëve europianë shpesh i atribuohet dëshprimit post-racionalist dhe mungesës së të gjitha shpjegimeve të pritshme nga filozofia racionaliste lidhur me problemet shoqërore dhe filozofike.

Një aspekt tjetër tejet me rëndësi në raportin e letërsisë shqipe me ato europiane e më gjerë të cilin e shtron profesor Qosja, është aspekti i interesimit të autorëve të letërsisë shqiptare për autorët e letërsisë europiane, aspekt të cilit i qaset duke e shikuar si një pjesë të rëndësishme të erudicionit të rilindasve tanë, erudicioni i shikuar në rrafshin sinkronik dhe diakronik. Duke na vënë në pah autorët europianë të periudhave të ndryshme të cilët citohen, përmenden apo përkthehen nga romantikën shqiptarë, Rexhep Qosja hap dyer të mëdha komunikimi mes letërsive tona. Dhe ky ndërkomunikim gjithësesi që fillon nga letërsia antike greke dhe romake si fillesat e kuptimësisë europiane letrare dhe filozofike, dhe interesimet për këtë letërsi përkrijnë me idetë e romantizmit shqiptar për origjinën antike të shqiptarëve nga njëra anë, dhe kulturës klasike të cilën këta autorë marrin gjatë shkollimit klasik të tyre. Në këtë vazhde të interesimit për vlerat klasike letrare bën pjesë dhe interesimi dhe për veprën e Dante Aligierit, i cili përveç që shihet si një kontakt me letërsinë dhe kulturën italiane, mbi të gjitha është poashtu pjesë e formimit shkollor klasik të rilindasve tanë. Përveç këtyre ndërkomunikimeve me letërsinë dhe autorët e saj, i një rëndësie të veçantë është ndërkomunikimi me autorë të bashkëkohësisë romantike europiane, dy nga të cilët përbëjnë shoqërues besnikë të romantizmit të Rilindjes Kombëtare: Bajroni dhe Lamartini. Që të dy këta romantikë, njëri anglez e tjetri francez, në mënyra të ndryshme shprehin njohuritë e tyre për Ballkanin në përgjithësi dhe shqiptarët në veçanti. Ndonëse edhe për Lamartinin edhe për Bajronin pika e parë identifikuese për Ballkanin në veprat e tyre është Greqia e cila rrikthehet në interesimin europian tani si një shtet i cili del nga pushtimi otoman dhe rilind të kaluarën e vet antike, megjithatë Shqipëria dhe shqiptarët janë pjesë e po këtij rajoni të përshkruar, të kënduar dhe të dokumentuar nga këta dy autorë. Për Rilindjen tonë kombëtare shkrimet e Lamartinit dhe Bajronit për Shqipërinë dhe shqiptarët kanë një kuptim dhe rëndësi të dyfishtë, si autorë të romantizmit me të cilët vihet në të njëjtin rrafsh edhe romantizmi shqiptar, si dhe një aspekt tjetër tejet i rëndësishëm, ai i rritjes së vizibilitetit të kulturës dhe çështjes shqiptare në qendrat europiane, qendra të cilat do të vendosin për ardhmërinë e Ballkanit dhe fatet e popujve ballkanikë.

Shënime përmbyllëse

Vepra Historia e Letërsisë shqipe – Romantizmi, padyshim që përbën njërën nga veprat më të rëndësishme të profesor Rexhep Qosjes dhe njëkohësisht njërën nga veprat bazë të historiografisë së letërsisë shqiptare. Të ndryshme dhe inovative për kohën e botimit të saj e bën qasja shumëdimensionale e autorit karshi zhvillimeve jo vetëm letrare të Rilindjes, por qasja e gjerë ndaj kësaj periudhe të jashtëzakonshme letrare dhe kombëtare të historisë sonë. Duke vënë në pah kompleksitetin hapësinor të lindjes dhe zhvillimit të Rilindjes në kolonitë e atëhershme shqiptare në më shumë kontinente dhe duke ndriçuar qasjet që kishte letërsia e Rilindjes ndaj poezisë popullore, çështjes së përdorimit të gjuhës shqipe si dhe pan-europianizmit të kësaj letërsie, arrijmë të kuptojmë që Rexhep Qosja me këtë vepër nuk bën vetëm një renditje të fakteve historiografike të kësaj periudhe, por mëton të bëjë të njohur dhe të kuptueshme këtë kohë të jashtëzakonshme të formimit tonë kolektiv kombëtar. Nga dimensionet e shumta analitike të kësaj vepre historiko- letrare gjithësesi që veçohet aspekti krahasues mes letërsisë romantike europiane dhe asaj shqiptare. Kjo qasje krahasuese është e një rëndësie të veçantë duke pasur parasysh orientimin europian të Rilindjes Kombëtare si letërsi, mendim intelektual dhe veprim politik nga njëra anë, dhe nevojës për të shtrirë kontekstin e të studiuarit dhe lexuarit të letërsisë shqiptare në përgjithësi në një hapësirë shumë më të gjerë nga ana tjetër. Janë shumë

karakteristika të cilat e bëjnë të krahasueshme këtë pjesë të letërsisë shqipe me atë europiane. Fillimisht është shumëgjuhësia e romantizmit shqiptar i cili në komunikim të drejtpërdrejtë autorët europianë me ata shqiptarë për të diskutuar mbi çështje letrare dhe shoqërore. Është poashtu edhe aspekti tematik ai i cili ofron platformën krahasuese të letërsive, por edhe diferencimin e tyre sa i përket kuptimit të ndryshëm të temave të njëjta. Historia dhe e kaluara janë një temë e përbashkët e romantizmit shqiptar dhe atij europian, megjithatë arësyet e përdorimit të temës janë të ndryshme në këto letërsi. Duke qenë se romantizmi europian emërtohet ndryshe edhe si *dhimbje e shekullit*, temat historike të kësaj letërsie kanë për qëllim largimin nga aktualiteti i kohës, ndërkaj, përdorimi i historisë si temë e romantizmit shqiptar ka për qëllim rikthimin tek e kaluara e lavdishme për të motivuar lëvizjen e organizuar çlirimtare nga Perandoria Otomane, lëvizje e cila do të prodhonte konceptin lidhur me zgjidhjen e çështjes shqiptare si dhe shtetin e parë të pavarur shqiptar. Veprimtaria më e gjerë e profesor Rexhep Qosjes është dëshmi e teorisë Midwell që shekulli i 19të është një shekull i cili zgjat gatisë për dy shekuj. Dhe kjo për arësyen që çështjet e hapura në Ballkanin e shekullit 19të nuk muarrën epilogun e duhur, duke lënë kështu të hapura dhe të pazgjidhura çështjet etnike që prodhuan jostabilitet, konflikte dhe luftëra. Në frymën e këtij realiteti duhet kuptuar dhe analizuar veprimtaria e Rexhep Qosjes si intelektual i zëshëm në vitet e shpërbërjes së Federatës Jugosllave dhe riaktualizimit të problemeve të papërmyllura të shekullit 19të.

Referencat

- [1]. Abazi, E&Doja A. (2016), From the Communist point of view: Cultural hegemony and folkloric manipulation in Albanian studies under socialism, *Communist and Postcommunist studies*, 49 (2), pp. 163-178;
- [2]. Balibar, E. (1991), *The Nation Form: History and Ideology, Race, Nation, Class, Ambiguous Identities*, with Immanuel Wallerstein, New York, Verso;
- [3]. Crichton, M. (1999), *Timeline, Imagine the Impossible*, New York, Alfred A. Knopf;
- [4]. Degovicz, Ch.C. (2022), *Austro-Hungarian Colonial Ventures: The case of Albania*, *Hungarian Historical Review* 11, No.2, Budapest;
- [5]. Doja, A. (2014), From the German-speaking point of view: Unholy Empire, Balkanism and the culture circle of particularism of Albanian studies, *Critique of Anthropology*, 34 (3), pp. 290-326;
- [6]. Duff, D. (2021), *Phases of British Romanticism*, Sophie Laniel-Msitelli (eds), *Romanticism and Time*, Cambridge, UK, Open Publishers;
- [7]. Halmi, N. (2021), *Periodisation and the Epochal Event*, Sophie Laniel-Msitelli (eds), *Romanticism and Time*, Cambridge, UK, Open Publishers;
- [8]. *Kënga e Nibelungeve*, (2016), Prishtinë, Shtëpia botuese Argeta Limg;
- [9]. Kiossev, A. (1995), The self-colonizing metaphor, *Cultural Aspects of the Modernisation Process*, TMV, Skriftserie No.3, Oslo;
- [10]. Kissinger, H. (1999), *Diplomacia*, Tiranë, Shtëpia Botuese e Lidhjes së Shkrimtarëve;
- [11]. Kohan P.S. (1971), *Istorija Zapadnoevropske Knjizevnosti*, Sarajevo, Veselin Maslesa;
- [12]. Laugier, S. (2015), The Ordinary, Romanticism and Democracy, *Comparative Literature Issue: Practices of ordinary*, Vol 130, No.5, pp.1040-1054, The Johns Hopkins University Press;
- [13]. Meadwell H. (2001), The Long Nineteenth Century in Europe, *Review of International studies*, N.27, p. 165-189, London, British International Studies Association;
- [14]. Oergel, M. (1998), *The return of King Arthur and the Nibelungen: national myth in nineteenth-century English and German Literature*, Berlin-New York, Walter de Gruyter;
- [15]. Qosja, R. (1979), *Prej tipologjisë deri te periodizimi*, Prishtinë, Rilindja;
- [16]. Qosja, R. (1984), *Historia e Letërsisë Shqipe – Romantizmi I, II, III*, Prishtinë, Rilindja;
- [17]. Said, E. (1979), *Orientalism*, New York, Vintage Books;
- [18]. Smith, A.D. (1991), The Nation: Invented, Imagined, Reconstructed?, *Millenium*, 20(3), pp. 353-368;
- [19]. Vasa, P. (1989), *E vërteta për Shqipërinë dhe shqiptarët*, Prishtinë, Rilindja;
- [20]. Xoxi, K. (1979), *Shqiptarët dhe Garibaldi*, Tiranë, Shtëpia Botuese 8 Nëntori;